



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|  |                                    |                                  |                                   |
|--|------------------------------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| Pranuar / Dërguar /<br>Prilazhen / Prilazhen /<br>Received / Delivered | 28.12.2023                         | 3                                | viti /<br>god /<br>Year           |
| Organizata /<br>Organ / Organizacija /<br>Org. / Unit                  | Bi Prost /<br>Bi Prost /<br>Prosto | Shtesa /<br>Prilog /<br>Appendix | Lloga /<br>Kolicina /<br>Quantity |
| SKM/SHK/7689/2023  |                                    |                                  | 115                               |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1359/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1359/2023, të datës 31.10.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "Transferim", në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 16 paragrafit 3 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1359/2023 e datës 31.10.2023, e parashtruar nga ankuesja**

**A r s y e t i m**

Nëpunësja civile (tutje referuar ankuesja), më datë 31.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1359/2023, kundër Vendimit me numër DM 691/2023, të datës 29.09.2023, të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak të: shkeljes së ligjit material, shkeljeve thelbësore të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa, kjo e fundit, me datë 14.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 6784/2023 të datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses me numër të Referencës 146/DMMPI 2 të datës 29.12.2022; Komunikimet elektronike të datës 09.02.2023 dhe 13.02.2023 ndërmjet ankueses dhe të Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe personave gjegjës; Vendimin me numër 49/2023 të

datës 22.02.2023, të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Komunikimi elektronik i datës 31.05.2023 ndërmjet ankueses dhe Drejtorit Menaxhues të AKP-së; Vendimin me numër 232/2023 të datës 19.06.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Komunikimet elektronike të datës 06.09.2023 dhe 14.09.2023 ndërmjet ankueses dhe personave gjegjës të AKP- së; Vendimin me numër 691/2023 të datës 29.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Komunikimet elektronike të datës 24.10.2023, 25.10.2023 dhe 26.10.2023, ndërmjet ankueses dhe të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe personave gjegjës; Raportin e punës 02/2023,04/2023 të Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin me numër 4367/2023 të datës 22.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimin e punës për pozitën Kryesues i Njesisë Për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor të datës 08.02.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.11.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës: Vendimin me numër Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 të Bordit të Drejtorëve AKP-së; Rregulloren NR.07-2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit të datës 30.11.2022 të Bordit të Drejtorëve AKP-së; Organogrami i Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Komunikimin elektronik të datës 06.12.2022 të ankueses dhe personave gjegjës; Përshkrimin e detyrave të punë Kryesues i Njesisë Për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor të datës 08.02.2021; Vendimin me numër DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 184/2023 të datës 12.05.2023, të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Komunikimet elektronike të datës 22.12.2022, 23.12.2022, 18.01.2023 ndërmjet ankueses të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore ; Vendimin me numër DM 27/2023 të datës 06.02.2023 Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore ; Komunikimin elektronik të datës 13.02.2023 ndërmjet ankueses dhe personave gjegjës; Propozimin me numër KR/07/2023 të datës 15.02.2023 nga Komisioni i Ristrukturimit ; Vendimin me numër DM 61/2023 të datës 22.02.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Propozimin me numër KR/20/2023 të datës 15.02.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Raportin e Punës 04a/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit të Ristrukturimit; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatët, vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime: D.B , B.B ,V.H , F.M , N.K, A.K; Shkresën zyrtare me numër 2087 të datës 13.06.2023 lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK me numër A.nr:556/2023; Propozimin me numër KR/24/2023 të datës 09.06.2023 nga Komisioni i Ristrukturimit; Vendimin me numër DM 232/2023 të datës 19.06.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër A.Nr.936/2023 të datës 01.09.2023 të KPMSHCK; Vendimin me numër A.nr.937/2023 të datës 04.09.2023 të KPMSHCK; Vendimin me numër Ref.BD-186/39 të datës 04.09.2023 të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve; Shkresën zyrtare e datës 13.09.2023 azhurnuara të punës për nivelin e mesëm dhe nivelin e ulët drejtues; Përshkrimin e Punës të datës 14.09.2023, të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 653/2023 të datës 29.08.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Raportin e Punës 07/2023 të Komisionit i Ristrukturimit të datës 27.09.2023; Propozimin me numër KR/28/2023 të datës 27.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 691/2023 të datës 29.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Komunikimet elektronike të dates 04.10.2023, 03.10.2023 02.10.2023 dhe 24.10.2023, ndërmjet ankueses si dhe personave gjegjës; Përshkrimin e Punës për ,Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale të datës 14.09.2023; Përshkrimi e Punës Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tenderit Publik të datës 14.09.2023; Akt emërimit e ankueses me numër Reference 92/DKR 30 të datës 27.10.2023 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër DM 691/2023 të datës 29.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër DM 747a/2023 të datës 14.11.2023 të Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së; Vendimin me numër DM 810/2023 të datës 08.12.2023 të Drejtorit Ekzekutiv AKP; Përshkrimin e Punës për pozitën Kryesues i Njesisë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor të datës 08.02.2023; Vendimet A.nr.936/2023 të dates 01.09.2023 dhe

A.nr.1223/2023 të dates 27.11.2023 të KPMSHCK-së; Vendimin me numër protokolli 7419/2023 të datës 12.12.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës A.nr.1359/2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, *sepse*:

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2022, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Andaj, në zbatimin e kësaj rregullore Komisioni i Ristrukturimit i themeluar sipas Vendimit DM 184/2023 të datës 12.05.2023, ka nxjerr raportin e punës 04a/2023 lidhur me pozitën Menaxher i Zyrës Rajonale në Mitrovicë, i anuluar sipas Vendimit A.nr.936/2023 të datës 01.09.2023 dhe Vendimit A.nr.937/2023 të datës 04.09.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Tutje, Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.09.2023, ka nxjerr Vendim për aprovimin e Rregullores Nr.05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku me nenin 43 të kësaj rregullore është shfuqizuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa, sipas vendimit të lartcekur kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.10.2023.

Drejtoresha e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 29.08.2023, ka nxjerrë Vendimin DM 653/2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa me Vendimin me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka amadamentuar Vendimin DM 653/2023 të datës 29.08.2023, ashtu qe, Komisioni të Ristrukturimit i është vazhduar afati i punës për 30 ditë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi.

Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bazuar në shqyrtimin e aplikacioneve të dy (2) kandidatëve për pozitën e punës Udhëheqësi Divizionit të Marketingut dhe Tenderit Publik në Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve, me Raportin e punës 02/2023, ka bërë vlerësimin e kandidateve sipas pikëzimit me ç'rast kandidati me inicialet A.L është vlerësuar me gjithsej 56.5 pikë, ndërsa kandidatja B.B, këtu ankuesja është vlerësuar me gjithsej 50.5 pikë. Ne zbatim të këtij Raport Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore me Vendimin DM 61/2023 të datës 22.02.2023 ka transferuar nëpunësin civil A.L në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tenderit Publik në Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve duke filluar nga data 01.06.2023.

Tutje në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datë 27.09.2023 ka nxjerrë Raportin e punës 07/2023, ku në bazë të këtij raporti komisioni ka shqyrtuar aplikacionet e gjashtë (6) kandidatëve për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës, ku sipas poentimit kandidatët janë renditur si në vijim: ankuesja është vlerësuar me gjithsej 53 pikë, kandidati me inicialet A. K është vlerësuar me gjithsej 52 pikë, kandidati me inicialet V. H është vlerësuar me gjithsej 51 pikë, kandidati me inicialet F.M është vlerësuar me gjithsej 43 pikë, kandidatja me inicialet N.K është vlerësuar me gjithsej 38 pikë si dhe kandidati me inicialet D.B është vlerësuar me gjithsej 36 pikë. Në zbatim të këtij raporti, ankuesja në bazë të Vendimit me numër DM 691 të datës 29.09.2023, të Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore, është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër Vendimit me numër DM 691/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore, pretendon se pas miratimit të Rregullores Nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKP, pozitën për Udhëheqës të Divizionit të Marketingut dhe Tender publik nuk është duke e ushtruar askush pasi që zyrtarit i cili e ka mbajtur këtë pozitë i është aprovuar pezullimi vullnetar deri me datë 01.10.2023 por që i njëjti nuk është kthyer në punë, andaj, pretendon që e njëjta të sistemohet në këtë pozitë. Shton së tek procedura e sistemimit të zyrtarit A.L në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tender publik nuk janë respektuar procedurat ligjore dhe nuk është bërë vlerësim i drejtë i gjendjes faktike si dhe pozitës së saj paraprake, respektivisht e njëjta pretendon se komisioni i ristrukturimit me rastin e transferimit të saj në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke u diskriminuar dhe duke i 'u mohuar e drejta e njohur me ligj, dhe se i njëjti nuk ka marrë parasysh asnjëherë prej kriterëve sipas Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit me rastin për transferimin e saj jashtë Prishtinës dhe vendosjen e një zyrtari tjetër në pozitën të cilën thekson se i ka takuar. Kërkon që Këshilli të aprovoj në tërësi ankesën e ankueses si të bazuar, të anuloj Vendimin DM 691/2023, të datës 29.09.2023, dhe të obligoj Drejtorin Menaxhues dhe Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore të AKP-së, që të nxjerr vendim lidhur me caktimin e ankueses në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Marketingut dhe Tender Publik si pozitë pasuese e pozitës së saj, me akt emërim të përhershëm në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes nga dhe ka konstatuar së nëpunësi civil ka kundërshtuar me ankesë Raportin e Punës 07/2023 të nxjerrë nga Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.1223/2023, të datës 27.11.2023, ka anuluar Raportin 07/2023 të Komisionit të Ristrukturimit të AKP-së lidhur me pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, si dhe vendimet me numër DM 690/2023 të datës 28.09.2023 dhe DM 692/2023 të datës 29.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së, mbi bazën e vlerësimit se Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka shqyrtuar drejtë faktet dhe dosjet e kandidatëve, andaj Këshilli ka konstatuar së raporti i shfuqizuar ka qenë në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, frymën e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar transferimit të nëpunësve civil si rezultat i ristrukturimit, dispozitave të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriterë: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet"*, si dhe hapave të përcaktuara përmes Udhëzuesit Nr. 02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses sa i përket transferimit të ankueses në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tender Publik, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me numër DM 810/2023, të datës 08.10.2023 ka pranuar dorëheqjen e nëpunësit A.L me efekt nga data 08.12.2023, si ushtrues i detyrës së kësaj pozite dhe i caktuar sipas vendimit me numër DM 61/2023 të datës 22.02.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së me efekt nga data 01.06.2023, ku si rezultat i dorëheqjes së zyrtarit në fjalë, ankuesja, përmes Vendimit DM 747a/2023 të datës 14.11.2023, të Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së është transferuar përkohësisht në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tender Publik, në kohëzgjatje prej 15.11.2023 deri 31.12.2023. Rrjedhimisht, ankuesja edhe përkundër se ka aplikuar dhe i është nënshtruar procesit të vlerësimit nga Komisioni i Ristrukturimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tender Publik, ku sipas Raportit të punës 02/2023 të Komisionit të Ristrukturimit, kandidati me inicialet A.L është vlerësuar si kandidati me më së shumti pikë gjithsej 56.5 pikë, duke u

sistemuar në këtë pozitë përmes vendimit DM 61/2023 të datës 22.02.2023, e njëjta nuk ka kundërshtuar me asnjë veprim juridik Raportin e punës 02/2023 të Komisionit të Ristrukturimit si dhe vendimin për sistemimin e nëpunësit civil A.L. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji konstaton se sistemimi i ankueses në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Marketingut dhe Tender Publik pa nënshtrim të procesit të vlerësimit nuk mund të ndodhë ligjërisht, pra sistemimi i ankueses në pozitën përkatëse mund të behët vetëm pas nënshtrimit të procesit të vlerësimit në pajtim me dispozitat e aplikueshme që rregullojnë procedurën e transferimit të nëpunësve civil, në rast të ristrukturimit të institucionit, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë se edhe pretendim ankimor është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit konstaton se meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.1223/2023 të datës 27.11.2023 ka shfuqizuar Raportin e Punës 07/2023 të Komisionit të Ristrukturimit të AKP-së, lidhur me vlerësimin e kandidatëve për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, atëherë, në vlerësimin e Kolegji çdo veprim dhe akt pasues që rrjedh nga ky raport konsiderohet i paligjshëm dhe pa pasoja juridike, e në këtë kuptim edhe Vendimi i kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimi DM 691/2023 i datës 29.09.2023 të Departamenti të Burimeve Njerëzore të AKP-së, konsiderohet si veprim juridik i shfuqizuar me Vendimin e Këshillit 1223/2023 të datës 27.11.2023.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafit 1.1 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1359/2023**

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësi të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së